UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 10, datë 4.7.2023

PËR SHFUQIZIMIN E UDHËZIMIT NR. 5, DATË 22.2.2023, "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PORTUALE NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS PËR VITIN 2023"

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës; të nenit 84, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të pikës 1, nenit 38, të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, "Për Autoritetin Portual", me propozimin e Autoritetit Portual Durrës, miratuar me vendimin nr. 5, datë 29.6.2023, zëvendëskryeministri dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

1. Udhëzimi nr. 5, datë 22.2.2023, "Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2023", shfuqizohet.
2. Tarifat për shërbimet portuale në Autoritetin Portual Durrës caktohen sipas tarifave të miratuara me udhëzimin nr. 4, datë 11.6.2021.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISE
Belinda Balluku

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj